



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 324 / Prot.
01

Tiranë, më 21.03.2024

AKT PËRPUTHSHMËRIE
PËR DOKUMENTIN E RISHIKIMIT TË
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA ROSKOVEC

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 9 dhe pikës 3 të nenit 23 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, të përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit, të Vendimit Nr. 4, datë 10.06.2020 të KKT-së "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Roskovec" ndryshuar me Vendim Nr. 1, datë 24.11.2021, të Vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit lidhur me përcaktimin e çështjeve, shpalljen e zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare në planifikim, të Strategjive Sektoriale në fuqi, të normave teknike të planifikimit si dhe të dhënave elektronike bazë, bazuar në shkresën nr. 676/1 Prot., datë 29.02.2024, protokolluar pranë AKPT me Nr. 272 Prot., datë 05.03.2024 e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për Dokumentin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Roskovec.
2. Akti i Përputhshmërisë lëshohet me kusht për njësinë strukturore RO_IN_IEN1_19/1, sipas argumentimit të më poshtëm:
 - a) AKPT vlerëson miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 1427/2 Prot., datë 05.02.2023 "Për ndërtimin e termocentralit me kapacitet të instaluar 170MW dhe vepra ndihmëse, i cili nuk është objekt konçensioni, me vend-ndodhje në Roskovec, Qarku Fier", projekti "TEC Roskovec CCPP" dhe rëndësinë prioritare të tij në fushën e energjisë;
 - b) AKPT vlerëson rëndësinë strategjike të këtij projekti për Bashkinë Roskovec, sa i përket ndikimit ekonomik të pritshëm;
 - c) AKPT vlerëson propozimin për pozicionimin e projektit, të kushtëzuar nga afërsia me infrastrukturën madhore të linjës Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) dhe stacioni ABV31 të TAP, distanca nga fasha mbrojtëse e projektit të rëndësisë kombëtare TAP 250m (bufe)

në të dy anët e tubacionit), distanca minimale nga zonat e banuara 500m, distanca minimale nga zonat naftëmbajtëse / puset e naftës 2000m dhe distanca minimale nga lumenjtë liqenet dhe burimet ujore: Lumi Seman, Rezervuari i Kurjanit, Këneta e Zezë 500m.

- d) AKPT vlerëson historikun e territorit të Bashkisë Roskovec, si zonë me karakter industrial, ku peshën kryesore ekonomike e ka luajtur dhe e luajnë aktivitetet me natyrë industriale-energjitike.

Në këto kushte, si institucion i specializuar në vlerësimin e propozimeve të përdorimit të tokës, mendojmë se propozimi i bashkisë për të mundësuar instalimin e industrisë energji-prodhuese në atë territor, në afërsi të linjës dhe stacionit dhe duke marrë parasysh distancat minimale të sipërcituara të sigurisë, sipas miratimit paraprak të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është i bazuar, ka kuptim dhe vlerësohet si i mundshëm dhe si i përputhshëm me kushtet territoriale dhe historike të territorit.

Sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin e tokës, në kushtet kur të mirat e përgjithshme ekonomike dhe energjitike që do të përftohen nga përdorimi i TEC-it, i miratuar në parim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, mund të tejkalojnë të mirat ekonomike që përftohen nga mbjellja e tokës me sipërfaqe 15.81 ha, vlerësojmë se duhet të vendoset nga organet politikëbërëse dhe vendimmarrëse, si Këshilli Bashkiak dhe Këshilli Kombëtar i Territorit.

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT


